



FATI IMPAKT
BETTER FUTURE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	16404/26
Nr. i fq. / Br. st	-3-
Data / Datum	21.04.2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



KOMUNA VUSHTRRI

02 Nr. BP 396/26
DT. 21.04.2026

Komuna e Vushtrrisë

Sheshi Ahmet Krasniqi Nr. 10

Përfaqësuar nga: Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
(tutje referuar si – "Komuna")

Fati Impakt

N.Fiskal:603601792

Me seli ne: Fshati Milloshe,rr. Viktora pn, Obiliq

Përfaqësuar nga : Bali Baliu

(tutje referuar si – Fati Impakt

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Në kuadër të iniciativës

"Pastrimi dhe mirëmbajtja nga mbeturinat në rrugët e rajonit/zonës së Shalës"

Neni 1 – Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Mirëkuptimit (në vijim: *MiM*) është përcaktimi i

bashkëpunimit ndërmjet **Komunës së Vushtrrisë** dhe **RITEK Fati Impakt powered by Fati Group** në kuadër të projektit "*Pastrimi dhe mirëmbajtja nga mbeturinat në rrugët e*

rajonit/zonës së Shalës" (në vijim: *Iniciativa*), i financuar nga **Fati Impakt powered by Fati Group** (në vijim: *Donatori*).

Projekti do të zbatohet në periudhën **Prill 2026 – Gusht 2027**. Komuna e Vushtrrisë do të përkrahë këtë iniciativë në lidhje me aktivitetet që zhvillohen brenda territorit të saj. Palët do të bashkëpunojnë për:

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen nga mbeturinat të hapësirave përgjatë rrugëve në rajonin/zonën e Shalës, duke përfshi Komunën e Vushtrrisë në zonat e thella të Shalës, me synim krijimin e një ambienti të pastër dhe pa mbeturina, duke ndikuar në rritjen e atraktivitetit turistik.
- Vendosjen e panove vetëdijësuese përgjatë rrugëve të zonës së Shalës, për të informuar qytetarët dhe opinionin publik mbi rëndësinë e ruajtjes së hapësirave publike.
- Nxitjen e vetëdijesimit për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave publike dhe zhvillimin e kulturës së kontributit komunitar.

Neni 2 – Përshkrim i shkurtër i projektit

Projekti "Pastrimi dhe mirëmbajtja nga mbeturinat e rrugëve në zonën e Shalës" është një iniciativë e përbashkët midis Komunës së Vushtrisë dhe RITEK powered by Fati Group, që synon të krijojë një ambient të pastër dhe të mirëmbajtur përgjatë rrugëve të Shalës. Financimi i projektit sigurohet nga RITEK powered by Fati Group, ndërsa periudha e zbatimit është **2026 – 2027**.

Qëllimi kryesor është pastrimi dhe mirëmbajtja sistematike e hapësirave përgjatë rrugëve të Vushtrisë, si dhe deri në zonat e thella të Shalës, për të përmirësuar atraktivitetin turistik dhe cilësinë e jetesës.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- **Pastrimi dhe mirëmbajtja:** Heqja e mbeturinave dhe mirëmbajtja e rregullt e hapësirave përgjatë rrugëve, duke angazhuar staf të paguar nga **Fati Impakt** powered by Fati Group.
- **Vendosja e panove vetëdijësuese:** Instalimi i panove informuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit publik.
- **Vetëdijësimi dhe edukimi:** Inkurajimi i bizneseve dhe individëve për të kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe pjesëmarrjen në projekte komunitare.

Ky projekt synon të jetë shembull i mirë i bashkëpunimit publik-privat në menaxhimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

Neni 3 – Bashkëpunimi ndërmjet palëve dhe përgjegjësitë

Komuna e Vushtrisë angazhohet të përdorë të gjitha kapacitetet e saj për të mbështetur realizimin e iniciativës dhe për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin korrekt dhe në kohë.

RITEK do të paraqesë një raport narrativ përfundimtar brenda tre muajve nga përfundimi i projektit.

Palët do të shkëmbejnë informacione gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Fati Impakt powered by Fati-Group angazhohet të ofrojë si shërbim:

- Mjetet/veturat për pastrimin,
- Personelin e nevojshëm për kryerjen e punëve,
- Shpenzimet operative të mjeteve dhe pagat e personelit,
- Sigurimin e mjeteve dhe personelit për kohëzgjatjen e projektit.
- Të organizoj dhe realizoj pastrimin periodik të zonave të përmendura në nenin 1.

Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrisë

- Komuna e Vushtrisë mundëson deponimin e mbeturinave pa kosto shtesë për Ritek powerd by Fati Group.

- Ofron mbështetje institucionale dhe koordinim me shërbimet komunale për zbatimin sa më efikas të aksionit.

Neni 5 – Qëllimi Shoqëror dhe Mjedisor

Ky aksion synon sensibilizimin e popullatës për mbrojtjen e mjedisit, jo vetëm në Shalë të Bajgores, por edhe në tërë territorin e Kosovës dhe rajonin, duke promovuar një kulturë të pastërtisë dhe përgjegjësisë qytetare.

Neni 6 – Konfidencialiteti

Palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave dhe dokumenteve që përdoren në kuadër të kësaj iniciative. Asnjë informacion nuk mund të përdoret për qëllime të tjera pa miratimin me shkrim të të dyja palëve.

Neni 7 – Kohëzgjatja dhe ndryshimet

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe përfundon më **30 gusht 2027**. Çdo ndryshim ose amendament do të bëhet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet palëve.

Neni 8 – Dispozita të Përgjithshme

- Ky Memorandum nuk përbën marrëveshje financiare ndërmjet palëve, pasi kontributi i Ritek powerd by Fati Group është donacion dhe Komuna ofron mbështetje pa pagesë.
- Çdo ndryshim ose plotësim i këtij Memorandumi bëhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim.

Neni 9 – Gjuha

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në katër kopje identike; secila palë mban nga dy kopje.

Data 21.04.2026

Për Komunën e Vushtrrisë
Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës



Ferit Idrizi

Për Fati Impakt powerd by Fati Group
Z. Bali Baliu
Përfaqësues dhe aksionar

Bali Baliu 21.04.2026